



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Legjislatura VIII  
Sesioni pranveror

---

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë  
Mbledhja nr. 25  
Prishtinë, më 23.5.2022, në orën 14:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Haki Abazi, Xhavit Haliti, Branislav Nikoliq, Adelina Grainca, Gazmend Gjyshinca, Ariana Musliu-Shoshi dhe Bahrim Shabani.

**Munguan:** Yllëza Hoti, Fitore Pacolli-Dalipi, Kujtim Shala dhe Time Kadrijaj.

**Në këtë takim ishte i ftuar:** z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, me bashkëpunëtorin Klisman Kadiu, këshilltar.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Liridona Gashi, kabinet/Kuvend; Ermira Gashi, Kuvend; Valon Bedrolli, Kuvend; Alma Haxhija, Kuvend; Shkumbin Halabaku, Kuvend; Lindita Rexha, Kuvend; Haki Huruglica, MPJD dhe media.

**Nga Zyra e Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Takimin e kryesoi:** Haki Abazi, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 22 e 29 mars dhe 5 e 26 prill 2022;
3. Raportim i zëvendëskryeministrit, z. Besnik Bislimi, lidhur me dialogun me Serbinë;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari konstatoi se komisioni e miratoi rendin e ditës.

**2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 22 e 29 mars dhe 5 e 26 prill 2022**

Kryetari konstatoi se komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 22 e 29 mars dhe 5 e 26 prill 2022.

#### 4. Të ndryshme

**Haki Abazi**, njoftoi se komisioni ka pranuar një ftesë nga kryetarja e Komisionit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli, për ta realizuar një vizitë zyrtare. Abazi tha se komisioni është i interesuar që ta realizojë këtë vizitë dhe propozoi që vizita të realizohet para përfundimit të qershorit.

Po ashtu, bëri të ditur se Kuvendit i është proceduar për shqyrtim Projektligji për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara, për të cilin komisioni ynë është i ngarkuar në cilësi të Komisionit funksional. Shqyrtimin në parim të këtij projektligji, komisioni do ta bëjë në mbledhjen e radhës, përkatësisht të martën më 31 maj 2022.

#### 3. Raportim i zëvendëskryeministrit, z. Besnik Bislimi, lidhur me dialogun me Serbinë

**Haki Abazi**, tha se është krijuar një situatë e re pas fillimit të luftës së pajustificuar dhe të paprovokuar në Ukrainë, e cila ka ndikuar në të gjitha aspektet e zhvillimeve ndërkombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Fokusi i këtij takimi tha se është dialogu me Serbinë dhe raporti me të cilin po zhvillohet ky dialog. Më tej, bëri të ditur se janë të njoftuar në mënyrë të pjesshme për dy marrëveshjet e fundit, ajo për energji dhe për targa. Abazi tha se është e qartë që Serbia në fund të procesit ka sabotuar finalizimin e këtyre dy marrëveshjeve dhe është për çdo lëvdatë qëndrimi i palës kosovare në procesin e finalizimit të këtyre dy marrëveshjeve, duke e mbajtur në qendër njohjen e pavarësisë së Kosovës.

**Besnik Bislimi**, tha se kanë pasur një dakordim që të fokusohen në marrëveshjen gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht të obligueshme, mirëpo ballafaqimi me marrëveshjen për targa dhe energjinë ka qenë detyrim, për arsye se marrëveshja e targave ka pasur një afat të skadimit më 15 shtator 2021 dhe kanë qenë të detyruar të gjejnë një zgjidhje. Kurse, sa i përket marrëveshjes për energjinë, tha se edhe pas marrëveshjes së vitit 2015 nuk është arritur që veriu të futet në sistemin normal të faturimit dhe pagesave për energjinë elektrike. Lidhur me marrëveshjen për targa njoftoi se është krijuar një grup punues, i cili ka pasur mandat që brenda një periudhe gjashtëmuajore të gjejë një zgjidhje finale. Grupet punuese janë koordinuar nga z. Lajçak dhe deri më 21 prill, kur ka qenë momenti i prezantimit të zgjidhjes finale, janë mbajtur shtatë takime në Bruksel. Dakordimi ka qenë që secila palë të pozicionohet dhe pastaj të shihet sesi pozicionimet mund të kanalizohen drejt një zgjidhje të përbashkët. Pala kosovare e ka zgjedhur opsionin e vet, mirëpo ka munguar vullneti i palës serbe që të pozicionohet për një nga opsionet që është permanent dhe në harmoni me standardet më të mira të BE-së. Në takimin e kryenegociatorëve, njoftoi se pala serbe ka kërkuar që t'i ofrohen gjashtë muaj shtesë, me arsyetimin se Serbia ndodhet në një fazë delikate të krijimit të institucioneve dhe rrjedhimisht e kanë të pamundur që të jenë aktivë në dialog. Lidhur me këtë bëri të ditur se janë duke përgatitur një plan B, i cili do të prezantohet para vendeve të Quint-it, dhe i cili do t'i ketë 30 ditë afat, para se të fillojë zbatimi i tij. Ai shtoi se nuk ka marrëveshje me Serbinë për çështjen e targave, për shkak të mosgatishmërisë së palës serbe për të gjetur kompromis. Te çështja e energjisë njoftoi se kanë prezantuar një udhërrëfyes sesi duhet të arrihet normalizimi i situatës me furnizim në veri, i cili ka paraparë licencimin e "Elektroseverit", si dhe faturimin e plotë. Për këtë, tha se janë paraparë 105 ditë dhe janë afër finalizimit të kësaj marrëveshje.

**Haki Abazi**, pyeti: A ka pasur çështje të tjera që janë diskutuar me z. Lajçak ose z. Borell, të cilat jo domosdoshmërisht janë bërë temë dite?

**Besnik Bislimi**, duke iu referuar pyetjes së kryetarit të Komisionit, bëri të ditur se kanë kërkuar zyrtarisht nga BE-ja që ta interpretojë marrëveshjen e asteriksit, për arsye se është parë një arbitraritet i madh i përdorimit apo zbatimit të kësaj marrëveshje në vendet e rajonit. Për këtë çështje, tha se kanë marrë një draft-dokument nga BE-ja dhe sapo të marrin komentet nga pala kosovare, ai bëhet interpretim zyrtar i BE-së, i cili e shpjegon mirë frymën pas marrëveshjes së asteriksit. Në çdo takim, përveç takimit të fundit, tha se është diskutuar çështja e të pagjeturve, në të cilin së bashku me kryesuesin e komisionit kosovar, z. Andin Hoti dhe z. Lajçak është punuar në përpilimin e një deklaratë të përkushtimit të liderëve të shtetit që të rritet intensiteti në trajtimin e problematikës së gjetjes së personave të zhdukur me dhunë. Një dokument i tillë do të paraqitet në atë moment kur takohen dy liderët e shteteve në Bruksel. Bëri të ditur se në momente të caktuara, pala serbe ka ngritur edhe tema shtesë, siç është çështja e personave të zhvendosur brenda shtetit; çështja e depërtimit në Kosovë me barëra si donacion humanitar, si dhe pengesat për vizitat zyrtare që përfaqësuesit serb i bëjnë në Kosovë.

**Gazmend Gjyshinca**, tha se dëshiron të dijë më shumë nga zëvendëskryeministri lidhur me perspektivën e tij për të ardhmen e afërt të dialogut. Më tej, shtoi se ka parë se në deklaratat e z. Lajçak, palët tashmë tekstet i kanë përafëruar në tri çështje kryesore që janë çështja e targave, çështja e energjisë dhe çështja e të pagjeturve. Lidhur me këtë pyeti: Në rast se ka një marrëveshje lidhur me këto tri problematika, si do të vazhdohet tutje?

**Besnik Bislimi**, lidhur me pyetjen e deputetit Gjyshinca, tha se nuk e di se a është në rregull që të japë perceptimin personal për atë se ku gjendet procesi dhe çfarë janë perspektivat. Për targat, tha se nuk ka marrëveshje, pasi që pala serbe ka refuzuar që të jetë konstruktive. Qëndrim zyrtar i Brukselit është se bisedimet kanë dështuar për shkak të mos vullnetit të palës serbe. Për energjinë, tha se janë afër, dhe ideja fillestare ka qenë që përmes këtyre marrëveshjeve të krijohet një lloj ambienti më komfort për fillimin e bisedimeve për marrëveshjen e përgjithshme. Për takimin e radhës, tha se ka qenë e paraparë që palët të dakordohen për dy dokumente. Dokumenti i parë është përkushtimi për gjetjen e personave të zhdukur me dhunë dhe dokumenti i dytë është për ndërtim të masave të mirëbesimit. Te dokumenti i fundit, bëri të ditur se kanë dërguar versionin e tyre, kurse BE-ja ka ndërtuar një version të përmbledhur dhe ka pritur komente nga pala serbe e cila vetëm më 13 maj ka dorëzuar komentet e veta. Bislimi bëri të ditur se nuk e sheh me shumë optimizëm në ndërrimin e kursit nga ana e Serbisë, e cila ka zgjedhur një strategji të participimit në Bruksel, por jo me idenë e arritjes së një marrëveshjeje. Më tej, tha se pala kosovare do të vazhdojë të dërgojë mesazhin se është e interesuar për marrëveshje, se është konstruktive e aktive me propozime, në mënyrë që edhe te vendi i fundit anëtar i BE-së, të përforcohet bindja se dialogu është duke u penguar për arsye të mosgatishmërisë së palës serbe, që të jetë konstruktive. Arritja e një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë po shihet me prioritet edhe nga vendet anëtare si rezultat i efekteve që janë prodhuar nga eskalimi i situatës në Ukrainë, por fatkeqësisht kjo nuk është përkthyer ende në ndryshim të qasjes në tavolinën e bisedimeve.

**Ariana Musliu-Shoshi**, tha se do të kishte dashur që ta ketë një raport të shkruar, i cili do të përbënte informata më konfidenciale se sa ato që zëvendëskryeministri mund t'i shfaqë në mbledhje. Ajo po ashtu tha se dialogu është mbi politikën e jashtme, mbi politikën ditore, mbi politikën e brendshme dhe se si parti kanë deklaruar se do të jenë konstruktive në këtë pikë, por shtoi se ka mungesë të transparencës në këtë proces. Përveç këtyre tri temave që u përmendën, pyeti: Cilat janë temat me prioritet në dialog, pasi që shprehu bindjen se janë më shumë tema që diskutohen. Po ashtu, pyeti: Cilët janë ekspertët që punojnë në grupin e zëvendëskryeministrit, pasi që ka dëgjuar për takime të ekspertëve? Lidhur me vizitën e zëvendëskryeministrit në Mbretërinë e Bashkuar, pyeti: Cili është qëndrimi i Mbretërisë së Bashkuar, sa i përket temës së dialogut? Znj. Musliu-Shoshi, po ashtu pyeti se a është i ndërlidhur procesi i dialogut me aplikimin e Kosovës në KE, pasi që në deklarinimin e fundit,

ministrja e Punëve të Jashtme të Gjermanisë ka thënë se një hap i tillë është shumë i rëndësishëm, mirëpo në të njëjtën kohë është shumë e rëndësishme që të kemi një proces i cili është i planifikuar mjaftë mirë. Ajo shtoi se është në dijeni që shtetet e Quint-it janë pro dialogut dhe pro një marrëveshjeje finale dhe i intereson të dijë se sa ky proces është i ndërlidhur me përkrahjen e tyre në aplikim në KE.

**Besnik Bislimi**, bëri të ditur se z. Lajçak, në mandatin e tij ka dy funksione, funksioni i parë është angazhimi në arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ligjërish të obligueshme dhe mandati i dytë është të asistojë dhe t'i mbështesë palët në implementimin e marrëveshjeve të kaluara. Në pjesën e dytë, Kosova e ka partner BE-në dhe rrjedhimisht kur ka probleme në implementimin e marrëveshjeve të kaluara, atëherë flasin me BE-në. Pastaj është në diskrecion të palëve të vendosin se cilat janë elementet apo temat që do të trajtohen brenda marrëveshjes gjithëpërfshirëse, mirëpo nuk ka tema tjera me interes.

Lidhur me vizitën në Mbretërinë e Bashkuar, tha se ka qenë e organizuar nga Fondacioni "Martti Ahtisaari" dhe ideja ka qenë që të mbahen takime me dy ish- lehtësuesit, znj. Ashton dhe z. Cooper e po ashtu në Dublin me ish-kryeministrin e Irlandës, në mënyrë që të përfitohet edhe nga përvoja e irlandezëve. Mirëpo, dakordimi i të dyja palëve ka qenë që diskutimi është krejtësisht privat dhe nuk mund të citojë deklaratat e asnjërit prej tyre. Përmes Ambasadës së Kosovës në Britani, bëri të ditur se janë organizuar takime shtesë në Qeverinë e Britanisë së Madhe dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, si dhe është takuar edhe me z. Stuart Peach, që është caktuar si përfaqësues Special i Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor. Bisedimet kanë qenë për tri angazhime kyçe, anëtarësimi në KE, procesi i avancimit të Kosovës drejtë NATO-s, dhe që pas publikimit të raportit për vendin, të aplikohet edhe për statusin e anëtarit kandidat. Për palën kosovare, tha se ka qenë e qartë që vendosja e njohjes në qendër të bisedimeve nuk nënkupton që ajo duhet të vijë para se të fillohen negociatat, por të gjitha diskutimet, të gjitha aranzhimet duhet të jetë si parakusht që po diskutojnë dy vende që e njohin njëra tjetrën. Ka ide që disa prej vendeve anëtare e shohin një ndërlidhje në mes progresit në procesin e dialogut dhe anëtarësimin në KE. Më tej, tha se qëndrimi ynë është që këto procese janë krejtësisht të ndara dhe rrjedhimisht duhet të mbahen si të tilla. Është me rëndësi që ky është edhe qëndrimi i Brukselit zyrtar apo personave në Bruksel që janë të përfshirë në procesin e dialogut. Lidhur me mos-transparencën dhe mosgatishmërinë për të raportuar, tha se kjo është hera e 12 që raporton në Kuvend. Duke iu referuar deputetes Musliu-Shoshi, lidhur me atë se subjekti i saj politik është i përcaktuar për konstruktivitet për procesin e dialogut, tha se në fillim e kanë ftuar ish- kryetarin e subjektit të saj politik për të biseduar për modalitetet e bashkëpunimit në këtë proces, por ai ka refuzuar të marrë pjesë në takim.

**Ariana Musliu-Shoshi**, pyeti zëvendëskryeministrin: A vlerëson se është më me rëndësi të kemi marrëveshje finale me njohje të ndërsjellë e më pas të bisedohet për çështje teknike apo anasjelltas? Nëse vlerëson se më i rëndësishëm është varianti i parë, pyeti atë se kur mendon se do të ndodhë dhe shtoi se vlerëson shumë të rëndësishme që të kemi një marrëveshje finale me njohje të ndërsjellët, e pas saj të vazhdojnë bisedimet teknike për një periudhë kohore që vlerësohet nga të dy shtetet.

**Besnik Bislimi**, theksoi se bazuar në Rezolutën e AP të OKB-së nuk është paraparë që ne të diskutojmë çështje të brendshme të Kosovës, por ja që dialogu ka devijuar dhe kemi përfunduar në këtë gjendje. Z. Bislimi tha se jemi në harmoni me shtyllën e parë të angazhimit të z. Lajçak, që thotë se duhet të flasim ekskluzivisht për arritjen e marrëveshjeve gjithëpërfshirëse. Temat të cilat jemi duke i trajtuar, tha se janë tema të trashëguara që kanë pasur afat skadence ose janë negociuar keq. Z. Bislimi theksoi se kanë preferencë që të fillohet sa më shpejt me marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe duhet shfrytëzuar këtë kohë e njëkohësisht është e nevojshme që edhe palët e aktorët tjerë në këtë proces të ushtrojnë trysni në palën serbe që të ulet në tavolinë.

**Ariana Musliu-Shoshi**, pyeti zëvendëskryeministrin: A mund të japësh më shumë informata se ku qëndrojmë me procesin e liberalizimit të vizave dhe kur qytetarët tanë mund të lëvizin lirshëm pa viza?

**Besnik Bislimi**, njoftoi se më 23 qershor do të mbahet mbledhja e radhës së Këshillit të Ministrave dhe pas zgjedhjeve në Francë mund të vendoset se a do të jetë në agjendë çështja e liberalizimit të vizave. Ai theksoi se janë duke punuar me secilin shtet anëtar, që çështja e liberalizimit të vizave të jetësohet e po ashtu njoftoi edhe për angazhimet e përfaqësuesve të institucioneve në këtë drejtim.

**Haki Abazi**, duke u ndërlidhur me dialogun, tha se në njërin anë e kemi Serbinë, e cila nuk ka vendosur sanksione ndaj Rusisë, si veprim direkt dhe furnizimin e kapaciteteve të saj nga Kina dhe Rusia për sektorin e sigurisë në Serbi, ndërsa në anën tjetër, e kemi Kosovën e cila në mënyrë pragmatike e konstruktive iu ka qasur dialogut në vazhdimësi dhe ka reflektuar për këto dy marrëveshje, për të cilat u diskutua. Nëse ne vazhdojmë të jemi konstruktivë, duke mbajtur të njëjtën linjë, ndërsa në anën tjetër Serbia hap kapituj të integriteteve evropiane, a është momenti i fundit që konsiderohet degradim i procesit nga viti 2011 dhe Kosova të jetë pengmarrëse e procesit integruar? Ndërsa, Serbia, për shkak të rëndësisë që ka në raport me Rusinë, vazhdon të trajtohet ndryshe nga qendrat e vendosjes.

**Besnik Bislimi**, në mes tjerash njoftoi se ka filluar të ndryshojë në tërësi paradigma e procesit të dialogut dhe pala kosovare shihet si palë bashkëpunuese, e cila është e interesuar të arrijë marrëveshje. Në Bruksel e kanë kuptuar që parakusht për të arritur marrëveshje të qëndrueshme është që marrëveshja të jetë korrekte. Ai përmendi marrëveshjen për asociacionin, për të cilën theksoi se nga viti 2013 e gjerë më tani, të gjitha ato subjekte politike të cilat e kanë mbështetur këtë marrëveshje kanë qenë në pushtet, por nuk e kanë zbatuar, për arsye se ka qenë jo e favorshme. Z. Bislimi tha se një marrëveshje jo të mirë duhet penguar në start dhe duhet të sigurohemi që marrëveshja i kontribuon procesit e nuk e minon atë.

**Ariana Musliu-Shoshi**, pyeti zëvendëskryeministrin: Cili është qëndrimi i Qeverisë për asociacionin, si e sheh zgjidhjen dhe cili është opsioni për zgjidhjen e marrëveshjes për targa?

**Besnik Bislimi**, bëri të ditur se në Bruksel janë nënshkruar 33 marrëveshje dhe mënyra e renditjes së tyre bëhet sipas alfabetit apo sipas radhës së nënshkrimit të tyre. Marrëveshjen për asociacionin e shohim si njërin nga 33 marrëveshjet e arritura. Sa i përket marrëveshjes për targa, tha se opsioni i palës kosovare ka qenë që të dy vendet kanë targa të përhershme, të cilat i përmbushin standardet e BE-së, që rrjedhimisht mund të pranohen targa e njëri-tjetrit, ashtu siç janë tani dhe nëse ka nevojë në ndonjë vend, mund të shtohet një paragraf se njohja e targave nuk nënkupton njohjen reciproke. Qasja e grupit kosovar ka qenë që të fillojnë të sillen si vende normale dhe t'ia njohin targa njëri-tjetrit.

**Haki Abazi**, pyeti zëvendëskryeministrin: A eksitojnë kushtet që dialogu të ketë rëndësinë e vet në përfaqësimin e interesave të serbëve lokalë në Kosovë dhe cilët janë parametrat që po e pengojnë një lloj dialogu që qytetarët do ta kishin mirëpritur edhe në veri edhe në jug, që kjo të jetë pjesë shtesë integrale për normalizimin e marrëdhënieve, si të parapara në Rezolutën e OKB, si pjesë e dialogimit të dy shteteve?

**Besnik Bislimi**, theksoi se duhet bërë ndarjen në mes të dialogut në Bruksel dhe dialogut me qytetarët e komunitetit serb që jetojnë në Kosovë, ngase janë procese të ndryshme dhe kanë objektiva të ndryshme. Përderisa në Bruksel synojmë t'i zgjidhim problemet e pazgjidhura mes dy shteteve, në Kosovë e kemi obligim që të sigurojmë integritetin e çdo qytetari, pa marrë parasysh cilit komunitet i përket. Edhe në Bruksel mendojnë se nuk ka asnjë vend, që me kushtetutë ka të drejta më të avancuara të komuniteteve sesa komunitetet në Kosovë. Nuk mund ta vëmë në diskutim integritetin e

komuniteteve, por problemet janë të logjistika dhe të ndryshme nga ato që prezanton Beogradi. Më tej, tha se Lista serbe zakonisht vjen me kërkesa nga Beogradi. Ai njoftoi se ka filluar një proces të dialogut të brendshëm me fascilitim të Ambasadës së Suedisë, por se ka ardhur në përfundim se nuk është i duhuri, pasi që është edhe kryenegociator, porse në takimin e radhës do të marrë pjesë edhe këshilltarja e kryeministrit për të drejtat e komuniteteve.

**Xhavit Haliti**, kërkoi të njoftohet nga zëvendëskryeministri lidhur me çështjen e asociacionit dhe për çështjen e qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese për pronën e kishës në Deçan. Ai po ashtu pyeti zëvendëskryeministrin, se gjatë bisedimeve mes palëve, a bisedohet vetëm përmes Lajçakut apo ndonjëherë bisedohet lirshëm lidhur me çështjen e targave e çështjet e tjera?

**Besnik Bislimi**, njoftoi se sa i përket asociacionit, ua kemi bërë të qartë edhe në Bruksel se jemi të interesuar për mekanizma që garantojnë në të njëjtën kohë avancimin e të drejtave të komuniteteve dhe siguri të plotë të sovranitetit dhe territorit të vendit, por sesi do të quhet ky mekanizëm dhe kur do të aplikohet, i mbetet së ardhmes. Nuk mund të sigurohet moscenimi i integritetit territorial, pa pasur marrëveshje gjithëpërfshirëse me Serbinë, e më pas mund të flitet për modalitetin më të mirë që siguron avancimin e të drejtave të komuniteteve dhe atë me principin e reciprocitetit. Ndërsa, sa i përket vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pronën e Manastirit të Deçanit, tha se nuk është i ndërlidhur me Brukselin dhe me dialogun. Zëvendëskryeministri njoftoi se nuk kanë pasur asnjë takim me palën serbe për të biseduar haptazi.

**Ariana Musliu-Shoshi**, pyeti zëvendëskryeministrin: Kur do të jetë takimi mes z. Kurti dhe z. Vuçiq, si dy persona vendimmarrës në të dyja vendet?

**Besnik Bislimi**, tha se nuk e ka një informatë të tillë, dhe sikur ta dinte datën e takimit, do ta ndante me anëtarët e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetar i komisionit,

---

Haki Abazi